



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.54..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 23/05/2022

VENDIM

Nr.14, datë 23 /05/2022

PËR

AKTIN E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT PËR REHABILITIMIN E DIGËS SË TAPIZËS

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 24, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 23.05.2022 mori në shqyrtim kërkesën për miratimin e aktit të kolaudimit të punimeve të zbatimit për Rehabilitimin e digës së Tapizës. Gjatë mbledhjes u diskutua në lidhje me problematikat në anën e poshtme të digës që janë konstatuar gjatë vizitës së ekipit të KKDM në terren të kësaj dige në Mars 2022, mungesa e perfaqësuesit të KKDM gjatë procesit të kolaudimit të digës (kërkesë e nenit 24 të VKM së mesipërme, etj.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratoj aktin e kolaudimit të punimeve të zbatimit për rehabilitimin e digës së Tapizës.
- 2- Ti kërkoj shfrytëzuesit të digës së Tapizës (Bashkia Krujë) të marrë masat për riparimin e problematikave të konstatuara dhe të hartoj një raport për Sigurinë e digës ku duhet të përfshihen plani i instrumentimit për monitorimin e digës, masat për operimin dhe mirëmbajtjen e digës në të ardhmen si dhe plani i gadishmërisë në rastet e emergjencave civile. Në raport duhet të jepen përveç konkluzioneve për sigurinë e digës edhe masat që do të ndërmerren në të ardhmen nga shfrytëzuesi i digës. Raporti duhet të pregatitet nga ekspertë të kualifikuar, të pavarur dhe të licencuar në sektorin e digave të mëdha. Njëkohësisht, Ekspertet duhet të pregatitin kurbën e volumeve aktuale të ujit në rezervuar bazuar në matjet e depozitimeve të materialeve të ngurta (matjet batimetrike të volumeve të ujit në rezervuar) në përputhje me kërkesat e nenit 30 të VKM së mesipërme si dhe instalimin e sistemeve të monitorimit online dhe në kohe reale të këtyre digave. Dokumentat teknike të mesipërme duhet të dorëzohen pranë SKDM brënda muajit Shtator 2022.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

